



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë, më, 06.06.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR SHQYRTIMIN E VEPRIMTARISË TË ENTIT RREGULLATOR TE ENERGJISË PËR VITIN 2018 DHE HARTIMI I DRAFTREZOLUTËS.

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenin 103, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, mori në shqyrtim raportin vjetor të ERE për vitin 2018 në mbledhjet e tij të datave 21.05.2019 dhe 06.06.2019.

Të pranishëm në seancën dëgjimore të datës 21.05.2019 për të bërë prezantim e raportit vjetor si dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve të deputeteve ishin Kryetari i Bordit të ERE-së, z. Petrit Ahmeti dhe anëtarët Adriatik Bego, Erjola Sadushi, Maksim Shuli dhe Rajmonda Islamaj.

Komisioni caktoi relator për këtë çështje Z.Arben Pëllumbi

- ***Baza ligjore***

Në përputhje me nenin 25 pika të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar dhe nenit 21 pika 1 të ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” Enti Rregullator i Energjisë paraqet në Kuvendin e Shqipërisë Raprotin Vjetor të Punës.

Komisioni përgjegjës bazuar në nenin 103, pika 2 të Rregullores së Kuvendit organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit dhe, në përfundim të diskutimeve, harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit dhe ia paraqet atë seancës plenare

Miratimi i kësaj projektrezolute kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi***

Në përmbushje të një prej detyrave kryesore të tij, atë të kontrollit parlamentar, Kuvendi i Shqipërisë bazuar në nenin 103, pika 2 të Rregullores së Kuvendit organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit vjetor të institucionit të pavarur dhe, në përfundim të diskutimeve, harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit dhe ia paraqet atë seancës plenare. Projektrezoluta përfshin vlerësime dhe konstatime lidhur me veprimtarinë e institucionit të pavarur, në rastin konkret të Entit Rregullator të Energjisë, për vitin 2018, si dhe rekomandime të cilat institucioni i pavarur duhet të ketë në konsideratë gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjatë vitit 2019.

- ***Diskutimi në komision***

Fillimisht e mori fjalën Z.Pëllumbi i cili në cilësinë e relatorit bëri një vlerësim të shkurtër të arritjeve kryesore të ERE si dhe të problematikave të këtij institucioni gjatë vitit 2018 në veçanti, dhe të sektorit të energjisë dhe gazit natyror në përgjithësi. Gjithashtu Z.Pëllumbi u ndal edhe në disa prioritete që ERE duhet të përmbushë gjatë veprimtarisë së tij në vitin 2019.

Në mënyrë të vecantë Z.Pëllumbi u ndal në:

Problematikat e mosbërjes efektive të ndarjes ligjore dhe funksionale të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nga ai i Furnizimit të Shërbimit Universal sh.a., Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a.,

Problematikat lidhur me ngritjen dhe bërjen efektive të bursës së energjisë.

Gjithashtu Z.Pëllumbi vlerësoi:

Miratimin nga ERE, në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit të “Planit të masave për OSHEE sh.a, për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike” i cili identifikon qartë përgjegjësitë e Furnizuesit në kuadër të detyrimit të shërbimit publik.

Vendimet e përbashkëta që Enti Rregullator i Energjisë së bashku me Entet Rregullatore të Greqisë dhe Italisë, kanë marrë në lidhje me projektin TAP-AG, vendime të cilat janë marrë në përputhje të plotë me Direktivën përkatëse të BE-së.

Miratimin e strukturës së re të ERE në prill 2019 kërkesë e vazhdueshme edhe në raportet ndërkombëtare përfshi edhe raport progresin si dhe nga Sekretariati i Energjisë, misionet e ekspertëve të BE-së në të cilët është theksuar domosdoshmëria e pavarësisë dhe rritjes së kapaciteteve njerëzore të ERE.

Trendin pozitiv sa i takon uljes së humbjeve të përgjithshme të raportuara nga OSHEE për vitin 2018, të cilat arritën në masën 23.96% krahasuar me shifrën prej 26.41% të një viti më parë dhe

inkurajon OSHEE të vazhdojë në këtë drejtim me qëllim arritjen e parametrave normal të operimit.

Nivelin e lartë të arkëtimeve në total i raportuar nga OSHEE sh.a. i cili ishte 101.9 % kundrejt Energjisë Elektrike të faturuar për vitin 2018, shifër në të cilën përfshihen edhe arkëtimet e prapambetura të periudhës 2007-2017.

Ndërkohë për vitin 2019 Z.Pëllumbi ndër të tjera theksoi që në veprimtarinë e tij ERE duhet:

Të bashkëpunojë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe me Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë për marrjen e masave të nevojshme për monitormin e ndarjes së OSHEE sh.a. sipas parashikimeve ligjore. Proces i cili shoqërohet me ndarjen ligjore, funksionale dhe organizative ndërmjet aktivitetit të shpërndarjes dhe Furnizuesit Universal. Nga ana tjetër të vijojë ndarja e aktiviteteve, llogarive dhe kostove midis Furnizuesit të Mundësisë së Fundit dhe aktiviteteve të tjera, duke mundur shërbim të sigurtë, kompetitiv, transparent dhe me cilësi të klientëve fundorë.

Të luaj një rol proaktiv për rishikimin e akteve ligjore dhe nënligjore respektive, gjatë periudhës tranzitore, për bërjen efektive të ndarjes ligjore dhe funksionale të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

T'i kushtojë një vëmendje të veçantë implementimit të planit të masave nga OSHEE sh.a. në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit si dhe përditësimit të tij në funksion të problematikave që kanë dalë përgjatë zbatimit të tij duke u fokusuar në zgjidhjen e ankesave të klientëve në një kohë sa më të shkurtër. Lidhur me zbatimin e tij të monitorojë në mënyrë periodike, çdo tre muaj, OSHEE dhe të informojë çdo katër muaj Kuvendin e Shqipërisë.

Të vijojë bashkëpunimin me aktorët e mandatuar për operimin dhe monitorimin e bursës së Energjisë.

Të caktojë afate konkrete për OSHEE lidhur me vënien sa më shpejt në punë të sistemit të ri të faturimit, të paktën në disa projekte pilot të identifikuar nga vetë OSHEE, i cili lehtëson në mënyrë të ndjeshme leximin e matjes së energjisë dhe krijon mundësi dhe opsione të reja , duke përfshirë edhe leximin periodik disamujor, si dhe në përfundim të konsultimeve me palët e interesit, aty ku kushtet teknike të kompanisë e lejojnë, të sigurojë përfshirjen në kontratën tip për vitin 2019 të kësaj mënyre leximi të sistemit të matjes.

Në bashkëpunim me OSHEE dhe institucionet përgjegjëse, të mbështesë propozimet për dhënien e një zgjidhje të problemit të pronësisë së kabinave elektrike, 51,3 % e të cilave nuk janë në pronësi të OSHEE-së, si dhe të disa rrjeteve shpërndarës të energjisë në pronësi private, duke krijuar kështu pengesa për të drejtën e ndërhyrjes dhe kryerjen e shpenzimeve financiare nga ana e OSHEE në rastet e nevojshme, si dhe të japë opinion nëse është e nevojshme për ndryshimet në legjislacion për zgjidhjen e këtij problemi në të ardhmen.

Të kërkojë nga OSHEE që në periudhë afatshkurtër të mundësojë lidhjen në rrjetin e shpërndarjes të impianteve fotovoltaike në ndërtesa, nxitja e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme është një prioritet i përcaktuar edhe në ligjin përkatës.

Të vijojë punën për mbrojtjen e konsumatorit përmes kompetencave që i jep ligji, mosrespektimi i afateve për shërbimet përkatëse, sjelljet arbitrare dhe të papërgjegjshme ndaj klienteve, vijnë të mbeten problem megjithë uljen e numrit të ankesave pranë ERE. OSHEE duhet të ofrojë një qasje të re për shërbimin e kujdesit ndaj klientit.

Më tej e mori fjalën Kryetari i Bordit të ERE-së, z. Petrit Ahmeti i cili bëri një paraqitje të veprimtarisë së ERE për vitin 2018. Z.Ahmeti u ndal në disa nga çështjet e rëndësishme të aktivitetit të ERE. Ndër pikat kryesore në të cilat u ndal Z.Ahmeti ishin:

- Një pasqyrë të zhvillimeve kryesore të sektorit të energjisë dhe gazit natyror;
- Problematikat e mosbërjes efektive të ndarjes ligjore dhe funksionale të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
- Mbrojtja e konsumatorit;
- Problematikat lidhur me ngritjen dhe bërjen efektive të bursës së energjisë
- Faktin që viti 2018 shënoi fillimin e prodhimit të energjisë nga impiantet fotovoltaike, prodhues të cilët i hapin rrugën një kategorie të re të klientëve të cilat janë të përhapur në vendet e Evropës Perëndimore të quajtur *Prosumers* të cilët prodhojnë Energji Elektrike për nevojat e veta dhe mund të shesin një sasi të Energjisë Elektrike në treg.
- Krijimi i kushteve të favorshme për investitorët

Deputetët shprehën shqetësimet e tyre në lidhje me tregun e energjisë dhe gazit natyror dhe kërkuan që ERE të luaj një rol proaktiv në lidhje me sfidat dhe zhvillimet e këtij sektori kaq të rëndësishëm.

Në mënyrë të veçantë Z.Beqaj u ndal në disa pika të rezolutës së një viti më parë dhe konkretisht për pikën lidhur me:

Marrjen e masave për zgjidhjen e problemit të pronësisë së kabinave elektrike, 51.3 % e të cilave nuk janë në pronësi të OSHEE sh.a., duke krijuar kështu pengesa për të drejtën e ndërhyrjes dhe kryerjen e shpenzimeve financiare nga ana e OSHEE sh.a. në rastet e nevojshme

Si dhe për pikën lidhur me:

Vënien në punë të sistemit të ri të faturimit, i cili lehtëson në mënyrë të ndjeshme matjen e energjisë dhe krijon mundësi dhe opsione të reja të nevojshme, duke përfshirë edhe matjen periodike disa mujore, si dhe përfshirjen në kontratën tip për vitin 2019 të kësaj mënyre matjeje.

Komisioni lidhur me këto çështje si dhe çështje të tjera të mundshme vendosi të organizojë, me datë 27 maj, një senacë dëgjimore të përbashkët mes ERE, OSHEE, KESH, OST.

Pas organizimit të seancës dëgjimore në mbledhjen e datës 6 qershor u diskutua dhe draft rezoluta për vlerësimin e veprimtarisë së, për vitin 2018. Deputetët u njohën me draft rezolutën e përgatitur e cila u lexua nga relatori, më tej, Z.Beqaj dhe Z.Sinaj bënë disa sugjerime të cilat u miratuan.

Në përfundim të mbledhjes komisioni me shumicë votash miratoi draft rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë (ERE) për vitin 2018.

Arben PËLLUMBI

Niko PELESHI

Relator

Kryetar